



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIK OF KOSOVO**

Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

Drejtoriati për Bujqësi, Inspeksion, Pylltari, Turizëm dhe Zhvillim Rural

Direktorijat za Poljoprivreda, Inspekciju, Šumarstvo, Turizam i Ruralni Razvoj

Directorate for Agriculture, Inspections, Forestry, Tourism and Rural Development

DATA/DATUM:	01.03.2024
REFERENCE-E:	09/Br.
PËR/ZA/TO:	Kancelariji Predsednika Opštine Dragaš
CC:	
PERMES/PREKO/THROUGH:	Skupšinska služba prevođenja
NGA/OD/FROM:	Drejtoriati për Bujqësi, Inspeksion, Pylltari, Turizëm dhe Zhvillim Rural Drejtor: Erdjan Limančé
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

TË NDERUAR! Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për rolin dhe kompetencat e Drejtorisë, Planin e Punës dhe detyrat specifike të përbajtura për vitin 2023 si aktivitetet bazë dhe puna e Drejtorisë përkatëse gjatë vitit 2023 u zhvilluan si më poshtë.

**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš**

02 Nr. 000/01-5952/24

11.03.2024

Dragash - Dragaš

SEKSIONI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:

Bashkpunimi me MBPZHR: Duke pasur parasysh se politika agrare shtetërore definohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorati për Bujqësi, Inspepcion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes Seksionit për Bujqësi dhe Turizëm, ka realizuar bashkëpunim të plotë me MBPZHR dhe zyrën regionale të MBPZHR në Prizren, për t'u siguruar fermerëve rrugën më të shkurtër të shërbimeve dhe përfitimit të mjeteve të pagesës së drejtpërdrejtë (subvencioneve), si dhe mjeteve të Grantit për zhvillimin e bujqësisë.

Programi i pagesave direkte të MBPZHR për vitin 2023 - subvencionet janë realizuar për 306 aktivitete bujqësore sipas caqeve të imbuvara në afatet në vijim:

- Prodhimi blegtoral (mjalje, majmëri, mjalje e deleve, dhive qumështore, pulave, shpendëve të mishit etj.),
- Bletarët,
- Pemishtet (për rreshtat e mbjella dhe rendimentin)
- Perimet (për sipërfaqet e mbjella dhe rendimentin)
- Pagesa direkte për mbjelljen e kulturave të mëdha (për kulturat e mbjella dhe për rendimentin), si dhe
- Cilësia e qumështit të shitur nëpër qumështore e licencuara dhe pika grumbullimi të licencuara (aplikim çdo 6 muaj).

Programi i granteve zhvillimore të MBPZHR për vitin 2023.

Ky program synon të mbështesë rritjen e konkurrencës së sektorit agro-rural, rritjen e prodhimit dhe produktivitetit, përmirësimin e sigurisë ushqimore, përdorimin e teknologjisë moderne, diversifikimin e aktiviteteve në ferma dhe ndërmarrje rurale, mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore, krijimin e vendeve të reja të punës dhe menaxhimin e qëndrueshmërit të burimeve natyrore.

Fondet e grantit ishin të destinuara për rindërtimin dhe ndërtimin e fermave për lopë qumështore dhe dele, për fermat e pulave vozitëse, gjegjësisht vezët në prodhimtarinë blegtoreale dhe mjetet e destinuara për prodhimtarinë bimore, si ndërtimi i serave, d.m.th. prodhimi i perimeve në një hapësirë të myllur, formimi i plantacioneve të frutave nën kulturën e mollës si dhe frutave të manaferrave (dredhëzave, mjedra dhe të tjera).

Në programin e MBPZHR - Thirrje për Grante në 2023

Sipas kriterieve të përcaktuara, fermerët, agropërpunesit dhe sipërmarrjet rurale kanë të drejtë të aplikojnë në disa masa dhe sektorë të Programit të Zhvillimit Rural 2023 si: MASA 1: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, MASA 3: Investimet në fizike asetet në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, MASS 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit si dhe MASS 5: Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal — Qasja LEADER.

Sektori i bujqësisë është i angazhuar dhe mobilizuar në mbështetje të vazhdueshme për nxitjen, plotësimin e dokumentacionit për aplikim tek fermerët, përpunuesit e produkteve bujqësore dhe ndërmarrjet rurale.

Përpunimi i informacioneve dhe njoftimeve për fermerët lidhur me pjesëmarrjen në konkurse:

ndihma dhe informatat u janë dhënë fermerëve për grumbullimin e dokumentacionit të caktuar për konkurs.

Bashkëpunimi me zyrën rajonale të Bujqësisë në Prizren: Lajmërimet dhe mbështetja për konkurs në projektet e Granteve dhe Subvencioneve (bletë, lopë qumështore, dele, dhi), organizimi i seminarit se si të bëhet një biznes plan për pjesëmarrje në Grante.

Këshilla për fermerë dhe grupe të fermerëve: Organizimi i trajnimeve për fermerët në prodhimtarinë blegtoriale. Aktivitetet bëhen në teren si dhe në hapësirat e sektorit.

Bashkëpunimi me CARTIAS-in: Vazhdimi i bashkëpunimit për realizimin e projekteve në sektorin e bujqësisë.

Bashkëpunimi me IADK-në: Vazhdimi i bashkëpunimit për realizimin e projekteve në sektorin e bujqësisë.

Bashkëpunimi me OJQ-të komunale: Bashkëpunimi për projektet bujqësore (trajnime, takime me të interesuar në sektorin e bujqësisë)

Vizitat e qumshtoreve për grumbullimi dhe përpunimin e qumshtit:

Me qëllim të arritjes së synimeve për ngritjen e kapaciteteve grumbulluese dhe ngritjen e cilësisë së qumështit dhe produkteve të tij. Si dhe ngritjen e cilësisë së qumështit nga ana e fermerëve, si dhe arritjen e qëllimeve në realizimin e subvencioneve nga Ministria për cilësinë e qumështit.

Ka një rritje të kënaqshme të cilësisë së qumështit për 6 muajt e fundit krashtuar me një vit më parë dhe një rritje në vëllim.

Vizitat e fermerëve në pikat sezonale (verore):

Kemi bërë disa vizita në terren, problemet mbetëri të njëjta, nevojitet mbështetja e autoriteteve shtetërore për përmirësimin e kushteve sanitare dhe higjienike.

Takimet dhe aktivitetet me bletarët: Regjistrimi i bletarëve, janë indentifikuar problemet dhe roli i shoqatës dhe Drejtoret për tejkalimin gjendjes aktuale (gjendja shëndetësore e bletëve). Në bazë të vërejtjeve të të gjithë bletarëve ka shqetësim përmes mbijetesë të këtij komuniteti. Probleme të dukshme me gjetjen e ilaçeve dhe ushqimit për shkak të lëvizjes së kufizuar të fermerëve.

Bashkëpunimi me pikat grumbulluese të bimëve mjekësore dhe frutave të malit - Bashkëpunim i gjerë në zgjidhjen e problemeve të këtij sektori dhe gjetja e mundësive përmes mbështetje të vazdueshme me subvencione dhe grante zhvillimore në rritje të kapaciteteve.

Takime dhe aktivitete me bletarët: Regjistrimi i bletarëve, mbajtja e evidencës në këtë sektor. Ka nevojë të vazdueshme përmes mbështetje me trajnime dhe këshilla të ekspertëve, si dhe mbështetje me subvencione dhe grante përmirësimin e kushteve të punës në nxjerjen e mjaltit, parandalimin dhe trajtimin, përgatitjet përmes mbrojtje nga sëmundjet.

Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja e të mbjellurave pranverore dhe vjeshtore: Prill, Maj, Shtator-Tetor. Mbjellja ishte planifikuar në 100 Ha, ishte realizuar në 75 Ha.

Organizimi dhe përcjellja e korrijeve: Korrik-Shtator. korrija është bërë sipas planit pa probleme të dukshme me rendiment mesatar sipas regjionit tonë.

Realizimi i Thirrjes Publike - Subvencionimi i ushqimit përmes kafshës 2023: Ky projekt është realizuar përmes një thirrjeje publike ku janë shpallur kushtet dhe kriteret përmes aplikimit. Në bazë të thirrjes publike kanë aplikuar gjithsej 254 aplikantë përmes bujqësorëve të cilët kanë plotësuar dokumentacionin e tyre, me gjithsej 254 përfitues në vlerë prej 87,807 euro (tëtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatë euro).

Kjo thirrje publike është planifikuar, realizuar dhe financuar nga buxheti i komunës në vlerë të përgjithshme prej 87,807€ përmes subvencioneve.

	Lopë mjelëse	Dele mjelëse	Dhitë mjelëse	Bletë	Fëllënza	Pula
Numri i krerëve	1639	9811	93	3586	650	7790
Vlera për krerë	30	3	3	2	0.3	0.2
Gjithsej	49170	29433	279	7172	195	1558
Gjithsej						87807

Realizimi i projektit Organizimi i panairit me prodhime lokale-vendore: Edhe këtë vit, si dhe vitin e kaluar, u organizua panairi i produkteve vendore. Ky projekt është realizuar përmes një thirrjeje publike ku përfitues i zbatimit ka qenë Shoqata e Biznesit të Sharrit të Dragashit, vlera e përgjithshme e projektit është 13.000 euro, është financuar nga buxheti komunal dhe mbikëqyrur nga sektori për bujqësi dhe zhvillim rural.

Në aktivitetet gjatë regjistrimit të prodhuesve bujqësorë dhe fermave, të cilat drejtohen si ferma komerciale, u formua gjendja dhe numri i blegtorisë, si dhe sipërfaqja e prodhimit të arave dhe frutave. Në vitin 2023 janë regjistruar edhe 26 fermerë të rinj.

Sektori i Inspeksionit:

1. Viti i inspektimit ishte një nga vitet më aktive.
2. Kontroll më i shpeshtë i tregut të kompanive për shkak të problemeve me 2 euro.
3. Lufta kundër usurpimit të pronës shoqërore.
4. Rritja e bashkëpunimit me AVUK-në në fushën e zbatimit të vendimeve për ndalimin e pirjes së duhanit në hapësira të mbyllura dhe zbatimin e ligjit të ri për mbeturinat.
5. Statusi vjetor i inspektimit për vitin 2023 është si më poshtë:

Nr.rr.	Emri dhe mbiemri i Inspektorit Dhe emri i inspeksionit	Numri i kontrollimeve me	Nr.i procesve me Vendim	Vendime	Nunari i kërkesave për procedurë kundërvajtëse	Asistime	Numri i ankesave të	Paralajmërimi	Vërejtje
1	Enis Sylejmani Inspektor i tregut	<u>147</u>	<u>145</u>	<u>4</u>	<u>5</u>	<u>1</u>	<u>1</u>	Kontroll pëndalesë me AVUK dhe Policinë	- Vazhdoi bashkëpunimi me AVUK dhe me Policinë e Kosovës në rastet e ndalimit të përdorimit të duhanit në ambiente të mbyllura.
2	Armand Piraçi Inspektor Komunal	<u>224</u>	<u>113</u>	<u>206</u>	<u>2</u>	<u>113</u>	<u>19</u>	<u>1</u>	- Kontrolli ka vazhduar në bashkëpunim me AVUK dhe Policinë e Kosovës në rastet e ndalimit të përdorimit të duhanit në ambiente të mbyllura.
3	Vetim Hasanit Inspektor i ndërtimit	<u>40</u>	<u>25</u>	<u>15</u>	<u>4</u>	<u>1</u>	<u>1</u>	<u>1</u>	Bashkëpunimi me policinë në 2 raste

Sektori i Pylltarisë:

- Është shpallur oferta përmes zyrës së prokurimit për shitjen e masës teknike në rajonet e planifikuara të komunës, tenderin e ka fituar kompania "BREDHIKU" SH.P.K. nga Prizreni, me të cilën u nënshkrua kontrata.
- Ka përfunduar shitja e lirë e masës së drurit për qytetarët e komunës.
- Drejtoria ka realizuar aktivitetet përtetje kufijve të kompetencës së saj në parkun nacional "Sharri" bazuar në Memorandumin e Komunës së Dragashit dhe Ministrinë e Mjedisit për shkak të zyrtarëve të pamjaftueshëm të parkut për komunën tonë.
- Kemi pasur 11 raste të zjarreve në pyje dhe dëmi vlerësohet në 2163.00.

Vërejtje: Sipas ligjit të ri për pyjet e Kosovës, kompetencat e Drejtorisë në fushën e mbrojtjes dhe zbatimit të planit janë bartur në zyrën rajonale të Agjencisë për Pyjet e Kosovës në Prizren.

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave	Të ardhurat
I. Të hyrat e administratës komunale të pylltarisë		
1.	Taksë për shitjen e masës drusore - Dru për ngrohje	28 606,80
2.	Taksë për shitjen e masës drusore - Dru teknik	2621,64
3.	Taksë për shitjen e masës drusore 50% nga kontrata	
4.	Taksat për shitjen e drurit teknik sipas normës (me pakicë)	3625,06
5.	Taksat e pastrimit të pyjeve	811,90
6.	Taksë për degët, degët e lajthisë, plehrat etj.	171,00
7.	Taksat për shërbimet nga pyjet private	148,50
8.	Taksat për transport	632,79
9.	Kompensimi i dëmeve në pyjore	3,90
	Gjithsej	37 576,26